



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2023:250763
Datë: 19.04.2024
Numri i dokumentit: 05596187

P.nr.2023:250763

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Samedin Cena, me bashkëpunëtorin profesional Sefedin Avdijaj në lëndën penale kundër të akuzuarit B.SH., nga Gjakova, për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së, i akuzuar nga Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm sipas Aktakuzës PP/II.nr.1609/23 të datës 16.11.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën 15.04.2024, në prezencën e Prokurores së Shtetit Shqiptonja Jupa dhe të akuzuarit B.Sh., me datë 17.04.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 19.04.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari,

B.SH., i lindur me datë ..., në Gjakovë, ku edhe banon në Rr. ”...” p.nr, nga i ati V. dhe e ëma Sh. e gjinisë B., i martuar, baba i një fëmije, i punësuar – kamarier, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të përfunduar shkollën fillore, me numër personal:..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datë 24.08.2023, rreth orës 01:40, në rr. ...” në Gjakovë, i pandehuri posedon narkotikë, substanca psikotrope apo analoge, në atë mënyrë që gjatë kontrollit sipërfaqësor nga ana e zyrtarëve policor, i pandehuri fillimisht tenton që të ikë por menjëherë kapet nga zyrtarët policor, ku të njëjtit i është gjetur një (1) qese me substancë narkotike, si dhe një qese tjetër najloni e mbushur me substancë narkotike të llojit Marihuanë të cilën i pandehuri e kishte hedhur gjatë ikjes, të cilat substanca sekuestrohen, ku pas ekzaminimit laboratorik AKF/2023-2849/23-2685

të datës 29.09.2023, rezulton se është substancë narkotike e llojit Kanabis (Marihuanë), me peshë totale prej 0.91 ±0.0001 gram,

- Me çka ka kryer veprën penale Posedimi i pautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4,7,17,38,39,40,43,69,70 dhe 269, paragrafi 2 të KPRK-së dhe neneve 242, 269, 358, 364 e 365 të KPPRK-së, i shqipton :

DËNIM ME GJOBË

Ashtu që i përcaktohet:

- I. Dënimi me gjobë në shumën prej 350 (treqind e pesëdhjetë) Euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. Nëse dënimin e shqiptuar me gjobë i akuzuari nuk mundet apo nuk dëshiron që ta paguajë gjykata konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, do ta zëvendësojë me dënim me burg në kohëzgjatje prej 17 ditësh, ku një ditë me burgim do të llogaritet me (njëzet) 20 Euro të gjobës.
- III. Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet procedurale sipas përlllogaritjes përfundimtare të gjykatës si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 25 € (njëzet e pesë Euro) si dhe në bazë të nenit 36 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20 € (njëzet Euro), në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- IV. Konfiskohet - narkotiku i llojit, Kanabis (Marihuanë), me peshë totale prej 0.91 ±0.0001 gram, konform nenit 269 par.3 të KPRK-së.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm pranë kësaj gjykate, ka parashtruar aktakuzën me numër PP/II.nr.1609/23 të datës 16.11.2023, kundër të akuzuarit B.SH., nga Gjakova për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve,

substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-ës, duke propozuar gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata për këtë çështje juridiko penale ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar me datën 15.04.2024 për të akuzuarin B.Sh. për veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së, në të cilin shqyrtim kanë marrë pjesë Prokurorja e Shtetit Shqiponja Jupa dhe i akuzuari B.SH.,

Para leximit të aktakuzës PP/II.nr.1609/23 të datës 16.11.2023 Prokurorja e shtetit deklaroi se pas verifikimit nga ana e gjykatës për të kaluarën kriminale për të akuzuarin B.Sh. rezulton se i njëjti nuk është kryes i veprës penale posedim i paautorizuar narkotike, substancave psikotrope ose analoge, ashtu që i njëjti rezulton se për herë të parë është kryerës i kësaj vepre penale dhe posedon më pak se 3 gram të substancës narkotikëve konkretisht posedon substanca narkotike të llojit kanabis (marihuanë) me peshë totale prej 0.91 gram andaj e bëj ndryshimin e kualifikimit ligjor të veprës penale ashtu që nga paragrafi 1 duhet të jetë paragrafi 2 i nenit 269 të KPRK-së.

I akuzuari B.Sh. pas leximit të aktakuzës së ndryshuar na Prokurorja e shtetit deklaroi se pas sqarimeve të mjaftueshme nga ana e gjykatës për favoret dhe pasojat e pranimi të fajësisë, lidhur me fajësinë deklaroi se e pranoj fajësinë ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës, për të cilën vepër jam penduar pa masë, prej asaj dite nuk e kam përdorur më asnjëherë substancën narkotike, shpreh keqardhje për rastin dhe i premtoj gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej më vepër penale.

I akuzuari B.Sh. më tej deklaroi se i propozoj gjykatës që të më shqiptoj një dënim sa më të butë pasi që jam edhe mbajtës i familjes.

Prokurorja e Shtetit Shqiponja Jupa lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari deklaroi se nuk e kundërshtojmë pranimin e fajësisë të bërë nga ana e të akuzuarit B.Sh pasi që ky pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa presion, duke i ditur pasojat dhe benifitet e një pranimi të tillë, pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes respektivisht provat materiale dhe personale që përmban aktakuza, e që në bazë të cilave është paraqitur gjendja faktike si në dispozitiv të kësaj aktakuze të ndryshuar sa i përket paragrafit 2 për shkak se i njëjti për herë të parë e ka kryer këtë vepër penale dhe i cili posedon më pak se 3 gram substancë narkotike të llojit marihuanë konkretisht në peshën totale prej 0.91 gram, ku edhe përmbushen elementet e veprës penale me të cilën ngarkohet. Po ashtu qëndroj pranë propozimit si në pikën III të aktakuzës dhe i propozoj gjykatës që substanca narkotike të konfiskohet dhe të bëhet shkatërrimi i saj konform neni 269 par 3 të KPRK-së. Po ashtu i propozoj gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor, ta dënoj sipas ligjit dhe ta obligoj në shpenzime procedurale. Lidhur me vendimin mbi dënimin i propozoj gjykatës që si rrethanë lehtësuese të merret pranimi i fajësisë për veprën penale për të cilën akuzohet, ndërsa i rrethanë rënduese të merret parasysh dashja e lartë e kryerësit për kryerjen e kësaj vepre penale.

2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Gjyqtari i çështjes në shqyrtim fillestar pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilën ka aprovuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari B.Sh. nga Gjakova për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 të KPRK-së, nga se ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 242 të KPPRK-së.

Gjatë pranimit të fajësisë gjykata ka fituar bindjen se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për veprën penale, që i vihet në barrë, dhe është bindur se pranimin e ka bërë në baza vullnetare, pas sqarimeve të mjaftueshme nga ana Gjykatës për pasojat dhe favorët e pranimit të fajësisë si dhe duke u mbështetur edhe në faktet dhe provat që i përmban Aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurorja e shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, andaj ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga ana e të akuzuarit.

Meqenëse i akuzuari ka pranuar fajësinë gjykata ka konsideruar se nuk do të ketë procedurë të provave e as fjalë përfundimtare.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë gjykata ka vërtetuar këto gjendje faktike se:

I akuzuari B.SH., nga Gjakova, ka kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 2 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, ashtu që me datë 24.08.2023, rreth orës 01:40, në rr. "UÇK" në Gjakovë, i pandehuri posedon narkotikë, substanca psikotrope apo analoge, në atë mënyrë që gjatë kontrollit sipërfaqësor nga ana e zyrtarëve policor, i pandehuri fillimisht tenton që të ikë por menjëherë kapet nga zyrtarët policor, ku të njëjtit i është gjetur një (1) qese me substancë narkotike, si dhe një qese tjetër najloni e mbushur me substancë narkotike të llojit Marihuanë të cilën i pandehuri e kishte hedhur gjatë ikjes, të cilat substanca sekuestrohen, ku pas ekzaminimit laboratorik AKF/2023-2849/23-2685 të datës 29.09.2023, rezulton se është substancë narkotike e llojit Kanabis (Marihuanë), me peshë totale prej 0.91 ±0.0001 gram,

Këtë gjendje faktike gjykata e vërtetoi edhe nga provat në shkresat e lëndës dhe atë: Raporti i Oficerit E.G., i datës 24.08.2023; Procesverbali mbi marrjen në pyetje të pandehurit B.SH., ë Stacionin Policor në Gjakovë me datë 24.08.2023; Deklarata e dëshmitarit V.G., e dhënë në Stacionin Policor në Gjakovë me datë 24.08.2023; Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i datës 24.08.2023; Raporti i ekspertimit AKF/2023-2849/23-2685 i datës 29.09.2023, Fotodokumentacioni dhe shkresat tjera në lëndë.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 269 paragrafi 1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge e kryen: *“Kushdo që pa autorizim posedon narkotikë, substanca psikotrope apo analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet”,* ndërsa në paragrafin 2 të këtij neni parashihet *“kryesi që kryen veprën nga paragrafi 1 i këtij neni për herë të parë dhe i cili posedon më pak se tre (3) gram të substancave narkotike apo substancave psikotropike ose analoge dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit”.*

Ndërsa në paragrafin 2 të këtij neni parashihet se: *“Kryesi që kryen veprën nga paragrafi 1. i këtij neni për herë të parë dhe i cili posedon më pak se tre (3) gram të substancave narkotike apo substancave psikotropike ose analoge dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit”.*

5. Vendimi

Duke u bazuar në këto që janë cekur me lartë, si dhe me vetë pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, gjyqtari i çështjes të akuzuarin B.Sh nga Gjakova, e ka shpallur fajtor për veprën penale për të cilën ngarkohet ngase në veprimet e të akuzuarit të përshkruara si në dispozitivin e këtij aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale, posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 të KPRK-së, e bazuar në këtë ka vendosur që të akuzuarin të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e matjes së dënimit, Gjykata i ka pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të parapara nga neni 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikonin në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit.

Si rrethanë lehtësuese, Gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: i vetëdijshëm për rrezikshmërinë shoqërore që paraqet kjo vepër penale, është penduar thellë për veprën penale të kryer, është mbajtës i familjes dhe premtimin se në të ardhmen nuk do ta përsëritë këtë vepër penale. Ndërsa si rrethana posaçërisht lehtësuese gjykata vlerësoi pranimin e fajësisë, shprehjen e keqardhjes për rastin që i ka ndodhur si dhe faktin se është hera e parë që bie ndesh me ligjin.

Ndërsa si rrethanë rënduese në këtë rast gjykata ka marrë parasysh rrezikshmërinë e kësaj vepre penale.

Gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikoj në parandalimin të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij dhe do të shpreh

gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi për konfiskim

Konform nenit 269 dhe nenit 276, par.1 dhe par.2, nënpar. 2.4 gjykata mori vendim për konfiskimin e substancës narkotike Kanabis (Marihuanë), me peshë totale prej 0.91 ±0.0001 gram e sekuestruar me datë 24.08.2023.

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet procedurale në emër të paushallit gjyqësor, është marrë konform nenit 452 paragrafi 1 të KPP-së, si dhe për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit duke u bazuar në nenin 36 paragrafi 3, nënparagrafi 3.1 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 364 të KPPRK-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.2023:250763, më datë 19.04.2024

Bashkëpunëtor profesional
Sefedin Avdijaj

Gjyqtari
Samedin Cena

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.